



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË

Nr. 1975 Prot.

Pukë, më 27/10 / 2020

PROJEKT-VENDIM  
Nr. 01 Date 27/10/2020

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT LIGJORE, SISTEMIT TE PIKEZIMIT  
PER APLIKIMIN NE PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL, SI DHE NGRITJEN  
E KOMISIONIT PER VLERESIMIN E DOKUMENTACIONIT

Mbeshtetur neni 24 dhe 54 shkronja k) te ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Veteqeverisje Vendore", te nenit 16 te ligjit nr.22/2018 date 03.05.2018 "Per Strehimin Social", ne perputhje me piken 5 te VKM nr.384, date 12.06.2019 te "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore", me propozim te Kryetarit te Bashkise, Keshilli Bashkiak,

Vendosi:

- I. Te miratoje formularin A tip "Kerkesa per te perfituar nga programet e strehimit social" si dhe formularin tip B "Deklarimi tip per vertetesine e te dhenave" e gjitha kjo mbeshetur ne piken 5 te VKM nr.384, date 12.06.2019 "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo programi social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore"
- II. Krijimin e komisionit te strehimit social per vlersimin e dokumentacionit ne kuader te programit per Banesa Sociale me kosto te Ulet. Komisioni do te perbehen nga 5 antare perfaqesues nga drejtorite dhe sektoret perkates:
  1. Zevendes/Kryetar
  2. Drejtoria e Ekonomise dhe finances

3. Sektori Juridik
  4. Drejtoria e Urbanistikës dhe planifikimit të territorit
  5. Perfaqësues nga organizata jo fitimprurëse
- III. Miratimin e formatit të sistemit të pikezimit për programin e banesave me kosto të ulët në mbështetje të plote të nenit 16 në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" sipas formatit bashkangjitur këtij projekt-vendimi.
- IV. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".
- V. U shpall me datë \_\_\_\_\_

**Hartues**

Behar ADEMI

Anjeza DODA

Pranvera TERBUNI

**Juriste**

Marte PLLUMI

**KRYETARI**

Gjon GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PUKE

Mir 1975/1, 1900t e

27.10.2020

RELACION

**MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT LIGJORE, SISTEMIT TE PIKEZIMIT PER APLIKIMIN NE PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL, SI DHE NGRITJEN E KOMISIONIT PER VLERESIMIN E DOKUMENTACIONIT**

**DREJTUAR : KËSHILLIT BASHKIAK PUKË**

Mbështetur neni 24 dhe 54 shkronja k ) të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisje Vendore”, të nenit 16 të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social”, në përputhje me piken 5 të VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e Vetëqeverisjes vendore”.

Bashka Puke ne kuadër te funksioneve qe ka ne drejtim te politikave sociale dhe kryesisht ne ofrim e programeve te strehimit social ne Bashkine Puke per here te pare pasi programe te tilla te strehimit social nuk jane aplikuar asnjehere me pare. Nisur nga përfundimi i investimit per ndertimin e 24 Banesave Sociale me Koste te Ulet financiar dhe ndertuar nga Enti Kombetar i Banesave sipas marrveshjes se miratuar nga Keshilli Bashkiak lind nevoja e miratimit te pikave te projekt vendimit te paraqitur pasi jane detyrime ligjore të përcaktuara ne legjislacionin per strehimin social ne Shqiperi. Dhe konkretisht ju sqarojme pikat e projekt vendimit te paraqitur:

1. Të miratoje formularin A tip “Kërkesa për të përfituar nga programet e strehimit social” si dhe formularin tip B “Deklarimi tip për vërtetësinë e të dhënave” formate te cilat jane te nevojshme per aplikim ne cdo program per strehimin social dhe eshte detyrim ligjor bazuar ne në piken 5 të VKM nr.384 ,datë 12.06.2019 “Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e Vetëqeverisjes vendore” e cila qarte përcakton se :

**Individi/familja paraqet kërkesën për të përfituar nga programet e strehimit social në çdo kohë, sipas formatit të miratuar nga këshilli bashkiak, bazuar në modelin që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “A” dhe sipas deklarimit tip për vërtetësinë e të dhënave që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “B”.**



Prandaj kerkojme miratimin e ketyre shtojcave sipas formatit ligjore qe te hapim rruge aplikuesver per aplikimet sipas formateve ligjore ne programet e strehimit social.

2. Krijimin e komisionit të strehimit social për vlersimin e dokumentacionit në kuadër të programit për Banesa Sociale me kosto të Ulët. Komisioni do të perbehen nga 5 anetare përfaqësues nga drejtoritë dhe sektorët përkatës:

- Zevendes/Kryetar
- Drejtoria e Ekonomise dhe Finances
- Sektori Juridik
- Drejtoria e Urbanistikes dhe planifikimit te territorit
- Përfaqësues nga organizita jo fitim prurëse, shoqeri civile

Ky komision krijohet ne zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social” dhe eshte pare e arsyeshme qe te kete specialist nga te gjitha fushat per ta bere sa me transparent dhe sa me profesional vleresimin e aplikimeve qe do vine per programet qe do lancohen.

Theksojme se ky komision do beje pikezimin dhe renditjen e aplikimeve te cilat do dorezohen ne strukturen perkatese te ngritur ne Bashkine Puke e cila do beje mbledhjen dhe evidentimin e gjithë aplikimeve nese kane plotësuar dokumentacionin perkates i cili eshte i përcaktuar ne Ligjet e strehimit social. Komisioni i ngritur do beje vetem pikezimin e aplikimeve sipas formatit qe Keshilli Bashkiak do miratoje dhe e gjithë lista e aplikimeve qe do plotesojne kriteret e përcaktuara ligjore do kalojne per miratim ne Keshillin Bashkiak. E gjithë procedura qe ndjeket si nga struktura sociale ne Bashkine Puke dhe nga Komisioni do jete sipas përcaktimeve ne legjislacionin per strehimin social. Cdo kriter apo dokument i kërkuar eshte qartësisht i përcaktuar ne ligje si dhe afatet perkatese per aplikime ne programet e caktuara qe do hapen.

3.Miratimin e formatit të sistemit të pikëzimit për programin e banesave me kosto të ulët në mbështetje të plotë të nenit 16 në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social” sipas formatit bashkangjitur këtij projekt-vendimi.

Kriteret e pikëzimit dhe pikët janë bazuar në sistemin e pikëzimit model sipas nenit 16 në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social” VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e Vetëqeverisjes vendore”, dhe VKM nr.574,date 29.08.2012

Kushtet e Pikëzimit me Total jane 100 pike të ndara sipas programeve te percaktura ne ligje ndersa fushave përkatëse pikezimi do vendoset nga antaret e këshillit Bashkiak duke përcaktuar nga këshilli prioritet qe kane ne sherbim te nevojave dhe kushteve qe paraqet Bashkia Puke. Theksojme se kriteret e vendosura nuk mund te ndryshohen pasi jane te përcaktuara qarte ne ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social”.



Formati i pikezimit tip do te perdoret per pikezimin e aplikimeve te cilat do kualifikohen ne fazen e dyte dhe te plotesojne gjithë dokumentacionin e kërkuar ne ligje.

Nr.	1.Kushtet e strehimit	Totali piket 20 Shperncarje sipas fushes
1	Nuk disponojnë banesë në pronësi	
2	Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje	
3	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	
4	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	
5	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	
6	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike	

Nr.	2.Kushtet familjare	Totali piket 30 Shperncarje sipas fushes
1	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	
2	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	
3	Familjet me më shumë se katër fëmijë	
4	Bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç	

Nr.	3 Kushtet Sociale	Totali piket 20 Shperncarje sipas fushes
1	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	
2	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç	
3	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve	
4	Familjet e policëve të rënë në detyrë	
5	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH)	
6	Punonjësit e repartit RENE A	
7	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	
8	Viktimat e dhunës në familje	
9	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;	
10	Anëtarët e komunitetit rom	
11	Anëtarë të komunitetit egjiptian	
12	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit	
13	Vajzat nëna	



14	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji.	
15	Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave përcaktohen familjet, sipas grupeve të të ardhurave, të përcaktuara në këtë ligj	

Nr.	4. Kushtet ekonomike	Totali piket 30 Shpërndarje sipas fushes
1	Të ardhura nën 80 % të të ardhurave mesatare	
2	Të ardhura deri 80 % - 100 % të të ardhurave mesatare	
3	Të ardhura 100 % -120 % të të ardhurave mesatare	

Ky format pikezimi është në përputhje me “Programin e banesave me kosto të ulët, në vijim BKU” dhe me poshtë japim disa informacione në lidhje me këtë program që pritet të implementohet në Bashkinë Puke për 24 banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banësive :

Banesë me kosto të ulët (BKU) konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t’u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

Neni 48 i ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për Strehimin Social” përcakton qartë se :

Përfituesit nga programi i banësive me kosto të ulët:

1. Përfitojnë nga programi i banësive me kosto të ulët familjet me të ardhura mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas përcaktimit të nenit 2, pika 45, shkronja “a”, e këtij ligji, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturës përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore: a) vërtetojnë se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie (vdekje apo sëmundje e rëndë) ose force madhore; b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit; c) janë të zhvendosura nga banesat, sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij ligji.

2. Kur përfitues është një familje që ka siguruar banesë nëpërmjet programeve sociale nga procesi i privatizimit ose nëpërmjet blerjes në tregun e lirë dhe sipërfaqja e banimit është nën normat e strehimit, bëhet shkëmbimi i banesës nën normë për të marrë një banesë në normat e nevojshme të strehimit, duke u llogaritur diferenca ndërmjet vlerës së banesës ekzistuese me vlerën e banesës me kosto të ulët që merr. Banesa ekzistuese nën normë bëhet pjesë e fondit publik të banësive dhe vihet në dispozicion të programit të banësive me kosto të ulët.

3. Normat e strehimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, edhe procedura e shkëmbimit të banesës me kosto të ulët, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 23 4.

Administrimi i kërkesave për këto banesa bëhet nga strukturat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Theksojme se niveli i te ardhurave mesatare per Bashkine Puke përcaktohet nga Instat dhe i eshte kërkuar me shkrese zyrtare nga ana e Bashkise Puke dhe do sherbeje si kriter përcaktues per kualifikimin apo mos kualifikim e aplikimeve qe do behet nga struktura pergjegjese ne Bashkine Puke. Theksojme se keto banesa do jepen per qytetaret per nje afat 20 vjecar sipas vleres perkatese te baneses per tu paguar me keste mujore nga ana e qytetarve, po ashtu sqarojme se deri ne likuidimin e plote te vleres se banesave ato ngelin ne pronesi te Entit Kombetar te Banesave deri ne likuidimin e vleres se detyrimit nga perfituesi tek Bashkia Puke dhe nga Bashkia Puke tek Enti i Banesave. Po ashtu sqarojme se e gjithë procedura ligjore per zbatimin e “Programit per banesa me kosto të ulët, në vijim BKU” eshte e përcaktuar qarte.

Bashkangjitur relacionit tabela permbledhese e 24 apartamenteve hartuar nga Enti Kombetar i Banesave ku vlere totale eshte 76.634.205 leke ku vlere mesatare per 1 apartament eshte 3.193.092 leke dhe nje afat shlyerje prej 20 vitesh.

Për sa sgaruam më larte në relacionin tonë kërkojme miratimin e këtij projekt-vendimi dhe vazhdimin e procedurave ligjore per zbatimin e programeve per strehimin social ne Bashkine Puke.

Hartues

Behar ADEMI

Anjeza DODA

Pranvera TERBUNI

*[Handwritten signatures]*

KRYETARI

Gjon GJONAJ





**ENTI KOMBËTAR I BANESAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

**FORMULARI NR. 1**


**LLOGARITJA E ÇMIMIT TË APARTAMENTEVE TË OBJEKTEVE**

**Banesa, 6 objekte me 24 apartamente**


**Blerësi BASHKIA PUKË**

<b>1. VLERA E SHPENZIMEVE TË OBJEKTEVE</b>	
Vlera përfundimtare e punimeve të ndërtimit të objekteve përfshirë vlerën e shërbimit të mbikqyrjes së ndërtimit, vlerën e punimeve të rrejtit inxhinierik, vlerën e shërbimit të mbikqyrjes së rrejtit inxhenjerik dhe shpenzime të tjera të parashikuara në ligj është në shumën	
	<b>61,105,959</b>
<b>SHUMA</b>	
	<b>61,105,959</b>
<b>2. VLERA E SHPENZIMEVE OPERACIONALE TË ENTIT</b> (4% e shumës së shpenzimeve të objekteve në lekë )	
	2,444,238
	<b>2,444,238</b>
<b>3. SIPERFAQE TOTALE E OBJEKTEVE</b> ( Pa pjesën në bashkëpronësi) m2	
	<b>1,877.52</b>
<b>4. KOSTO PËR M2 SIPERFAQE NDËRTIMI E OBJEKTEVE</b>	
a) Vlera e shpenzimeve të objekteve	61,105,959
b) sipërfaqja totale e ndërtimit, pa sipërfaqen totale të bashkëpronësisë	1,877.52
c) Kostoja e sipërfaqes së ndërtimit pa pjesën në bashkëpronësi për m2	<b>32,546.1</b>
<b>5. LLOGARITJA E KOSTOS SË TRUALLIT</b>	
a) Sipërfaqja totale e truallit në bashkëpronësi	1,059.2
b) sipërfaqja totale e ndërtimit, pa sipërfaqen totale të bashkëpronësisë	1,877.52
c) Koefficienti i truallit	<b>0.564</b>
<b>4. ÇMIMI I APARTAMENTEVE TË OBJEKTEVE</b>	
a) Vlera e apartamenteve me interes 2% në vit	74,189,967
b) Shpenzimet operationale (4% e pikës 2)	2,444,238
c) Çmimi i apartamenteve (a+b)	<b>76,634,205</b>

**Drejtori Teknik  
Ziramina PRODA**



**Drejtori Ekonomik  
Marko DHANA**



# KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

## KËRKESE

### PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NË LIGJIN NR. 22/2018, "PËR STREHIMIN SOCIAL"

#### FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri .....emri.....datëlindja.....  
 Qyteti ..... Njësia administrative ..... Rruga.....  
 Pall. .... Shk. .... Ap. .... (Në rastin e një banese private) Nr..... Tel.....

#### I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATËLINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/0000)	(1) SEKSI	(2) GJENDJA CIVILE	Nr. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJARËT	(4) PUNËSIMI

Në tabelë hidhen kodet, si më poshtë vijon:

#### 1. SEKSI

Mashkull (M)  
 Femër (F)  
 Nuk  
 Përgjigjem (N)

#### 2. GJENDJA CIVILE

Beqar/e  
 i/e martuar  
 i/e ve  
 i/e divorcuar

#### 3. FAMILJARËT

1 Aplikanti  
 2 Nëna/Babai  
 3 Bashkëshorti/ja  
 4 I biri/E bija  
 Gjysh/e  
 Nip/Mbesë  
 Vjehri/a  
 Dhëndri/nusja  
 Vëllai/motra  
 Kunati/a  
 Të tjerë

#### 4. PUNËSIMI

0 Punësuar në shtet 01  
 1 Punësuar në privat 02  
 2 I/E vetëpunësuar 03  
 4 Punësim i rastit 04  
 5 I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike 05  
 6 I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë 06  
 7 Të tjerë 07  
 8  
 9  
 10  
 11



**Shënim:** Në kolonat 1, 2, 3 e 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës 3 duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare.

## II. KUSHTET E STREHIMIT

PO JO

2. Disponon banesë në pronësi.....

2.1. Nëse **PO**, jep informacionin e saktë për:

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës 3, të tabelës “Gjendja familjare”) \_\_\_\_\_
- Prona ka një strukturë:
  - garsoniere .....
  - struktura e apartamentit 1+1 .....
  - struktura e apartamentit 2+1.....
  - struktura e apartamentit 3+1.....
  - Sipërfaqja totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë .....
  - Sipërfaqja totale e banimit.....

2.2. Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën 2, vazhdoni me plotësimin e informacionit, si më poshtë vijon:

- Banoj me qira .....
- Banoj me prindërit .....
- Banoj në banesë informale .....

2.3 Banoj në banesë rrezik shembjeje .....

2.4 Banoj në banesë të mbipopulluar .....

2.5 Kam mbetur i pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore .....

Në sipërfaqen totale të banimit përfshihen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brenda mureve ndarëse.



2.6 Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore

.....

2.7 Banoj në banesë që prishet/përjashtohet nga legalizimi

.....

### III. KUSHTET FAMILJARE

*Shëno vetëm në një kuti që i përshatet kushtit tuaj familjar*

3.1 Familje një prindërore që kam në ngarkim fëmijë .....

3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u  
strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore.....

3.3 Familje me më shumë se 4 fëmijë .....

3.4 Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç .....

### IV. KUSHTET SOCIALE

*Shëno në kutitë që u përshatën kushteve tuaja sociale*

4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara.....

4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç .....

4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimt të banesës ish-pronarëve .....

4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant

4.5. Azilkërkues .....

4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë .....

4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) .....

4.8 Punonjës i RENEAs .....

4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri .....

4.10 Viktimë e dhunës në familje .....

4.11 Viktimë e trafikimit .....

4.12 Anëtar i minoritetit rom .....

4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian .....

4.14 I mitur në konflikt me ligjin .....

4.15 Vajza-nëna .....

4.16 Komuniteti LGBTI .....

4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike .....

## V. TË ARDHURAT E FAMILJES

*Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje, në përputhje me kolonat 3 e 4, të tabelës "Gjendja familjare". Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transfera të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankare etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve, si: taksa, tatime e sigurime shoqërore.*

Të ardhurat totale mujore të familjes .....

Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve, sipas kolonës 3, të tabelës

"Gjendja familjare"

00 ..... 04 ..... 08 .....

01 ..... 05 ..... 09 .....

02 ..... 06 ..... 10 .....

03 ..... 07 ..... 11 .....

Të ardhura nga emigracioni (vjetore) .....

Të ardhura nga qiraja (mujore) .....

Të ardhura të tjera (vjetore) .....

## VI. FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJËRIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT<sup>2</sup>

**Unë dhe familja ime kërkojmë të trajtohem me strehim nëpërmjet programit të:**

*(Rendit nga 1 deri në 4, sipas preferencës: 1 për preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)*

- Banesë sociale me qira .....

- Përmirësimi i banesës .....

- Banesë me kosto të ulët .....

- Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë .....

**Shënim:** Forma e përfitimit mund të ndryshojë nga ajo që ju keni cilësuar si më të preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.

<sup>2</sup> Banesat e përkohshme dhe banesa e specializuar, si rregull, propozohen nga bashkia, për rastet e veçanta, dhe nuk ofrohen si alternativa.

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranoi, duhet të shënoni:

Pranoj      Nuk  
                 pranoj

Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi  
i qirasë në tregun e lirë .....      

Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet,  
sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive....



DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj sa më poshtë:


1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se, për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se, nëse përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare, mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në KREUN IV të këtij formulari.

Nënshkruar në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_

Deklaruesi:

(Emër/Mbiemër/Firmë)

\_\_\_\_\_



VËRTETIM QË KONFIRMON REGJISTRIMIN E KËRKESËS, OBJEKTIN E SAJ, DATËN  
DHE LISTËN E DOKUMENTEVE TË BASHKËLIDHURA

Vërtetim regjistrimi kërkesë

(NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/201....

**Lënda:** Vërtetim regjistrimi kërkesë për përfitimin nga programet e strehimit social

**Drejtuar:** Z./Znj. \_\_\_\_\_  
(adresa)

I nderuar Z./Znj. \_\_\_\_\_,

Vërtetojmë se ju keni paraqitur kërkesën me nr. \_\_\_\_\_ protokolli, datë \_\_\_\_\_, e cila është regjistruar pa të meta pranë \_\_\_\_\_ (njësia e vetëqeverisjes vendore), me anë të së cilës paraqisni preferencën tuaj për përfitimin nga programi \_\_\_\_\_ i strehimit social.

Kërkesa juaj është regjistruar me nr. \_\_\_\_\_ në regjistrin elektronik të sistemit të pikëzimit.  
Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë depozituar edhe dokumentet, si më vijon:

	Titulli i dokumentit	Nr. i faqeve

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

\_\_\_\_\_  
(emri i punonjësit, firma)

DEKLARUESI

(\_\_\_\_\_)

**DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E****DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT****DEKLARATË**

PËR

DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR  
NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë \_\_\_\_\_, i biri i/e bija e \_\_\_\_\_ dhe i/e \_\_\_\_\_,  
 lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, dhe banues/banuese në  
 \_\_\_\_\_, me shtetësi \_\_\_\_\_, me numër  
 identifikimi \_\_\_\_\_, me vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

Mbështetur dhe në zbatim të:

Pikës 16, të vendimit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, të Këshillit të Ministrave, "Për  
 përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të  
 strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes  
 vendore";

pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social";

të neneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave

personale",

	Deklarimi	Firma (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
1.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave.</li> <li>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</li> <li>- Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve social të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social.</li> </ul>	
2.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave;</li> <li>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</li> <li>- Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".</li> </ul>	

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_, 20\_\_\_\_



## FORMAT I ISISTEMIT TE PIKEZIMIT

Kriteret e pikezimit dhe piket jane bazuar ne sistemin e pikezimit model sipas nenit 16 ne ligjin nr.22/2018 date 03..05.2018 "Per Strehirnin Social" VKM nr.384,date12.06.2019 te "Per Percaktimin e dokumentacionit per te perfituar strehim sipas çdo program social te strehimit dhe te afateve e te procedurave te miratimit nga organet e Veteqeverisjes vendore",

Kushtet e Pikezimit me Total 100 pike te ndara nga Keshilli Bashkiak sipas programeve dhe fushave perkatese.

Nr.	Kushtet e strehimit	Total pike 20, shperndarja sipas fushes
1.	Nuk disponon banese ne pronesi	
2.	Banojne ne banesa qe paraqesin rrezik shembje	
3.	Banojne ne banes ate mbipopulluara, sipas percaktimeve dhe normave ne fuqi	
4.	Kane mbetur ose rrezikojne te mbeten te pastrehe si rezultat i fatkeqesive natyrore	
5.	Familjet ose individet qe humbasin banesen e tyre sipas zhvendosjes ose zbatimit ten je vendimi gjyqesor	
6.	Banojne ne banesat qe prishen ose perjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike	

Nr.	Kushtet familjare	Total pike 30, shperndarja sipas fushes
1.	Familjet nje prinderore qe kane ne ngarkim femije te perfshire edhe vajzat nena	
2.	Te moshuarit qe kane mbushur moshen e pensionit dhe nuk perzgjidhen per tu strehuar ne institucionet publike te perkujdesjes shoqerore	
3.	Familjet me me shume se 4 femije	
4.	Bashkeshortet, mosha e pergjithshme e perbashket e te cileve arrijne deri ne 690 vjeç	

Nr.	Kushtet sociale	Total pike 20, shperndarja sipas fushes
1.	Personat me aftesi te kufizuar ne perputhje me percaktimet e	

	bera me vendim te kehshillit te ministrave	
2.	Individet me statusin e jetimit qe nga statusi i daljes nga qendrat e perkujdesjes shoqerore e deri ne moshen 30 vjeç	
3.	Familjet e mbetura te pastreha per shkak te lirimit te banesave ish-pronareve	
4.	Familjet e policeve te rene ne detyre	
5.	Punonjesit e reparteve te nderhyrjes se shpejte FNSH	
6.	Punonjesit e repartit RENE A	
7.	Punonjesit e sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin	
8.	Viktimat e dhunes ne familje	
9.	Viktimat e trafikimit/ viktimat e mundshme te trafikimit	
10.	Anataret e komunitetit rom	
11.	Antaret e komunitetit egjiptian	
12.	Te miturit ne konflikt me ligjin, sipas parashikimeve te kodit te drejtesise penale per te mitur pas ekzekutimit te denimit	
13.	Vajzat nena	
14.	Individet qe i perkasin komunitetit LGBTI, te cilet jane viktima per shkak te orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar ne vendimin e organit kopotent, sipas legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen nga diskriminimi qe percakton se si pasoje e diskriminimit individi nuk ka nje strehim te pershatshem dhe qe kane te ardhura te pamjaftueshme ose qe nuk kane fare te ardhura sipas percaktimeve te bera ne nenin 3 te ketij ligji.	
15.	Kushtet ekonomike ne baze te te cilave percaktohen familjet sipas grupeve te te ardhurave te percaktuara ne ligj	

Nr.	Kushtet ekonomike	Total pike 30, shperndarja sipas fushes
1.	Te ardhura nen 80% te te ardhurave mesatare	
2.	Te ardhura deri ne 80% - 100 % te te ardhurave mesatare	
3.	Te ardhura deri ne 100% - 120 % te te ardhurave mesatare	